

KËRKESAT TONA NGA TAKIMI BERISHA –RAMA PËR PRESIDENTIN.

Nga ndërkombëtarët vazhdimisht bëhet apel që Shqipëria të pershpejtojë reformat që të pranohet vend kandidat në BE. Në Evropë nuk mund të shkohet pa zgjidhur problemin e pronës, sepse Europeanët e kanë respektuar gjithmonë të drejtën e pronësisë..

Nga takimi Berisha –Rama i dt 3 Qrshor 2012, nuk duam një President kukull në duart e politikave antishqiptare.

Kërkojmë një President që të garantojë respektimin e Kushtetutës që të kuptojë dhe të kundërshtojë jo vetëm ligjet e brendëshme antikushtetuese për pronën por dhe rekomandimin e fundit të Bankës Botërore, në prill 2012 për menaxhimin e pronës. Të gjithë duhet të dinë se populli shqiptar nuk ka nevojë për armiq të tjerë , pasi për tu shkatërruar mjafton kjo politikë e B. Botërore dhe mungesa e vullnetit politik për ta kthyer pronën tek i zoti . Ky raport i specialistëve të B. Botërore , me justifikim “zgjidhje pragmatike e problemit të pronës”, duke mos marrë parasysh asgjë nga vërejtjet , nga projektligji dhe zgjidhjet që ka ofruar shoqata , e saboton në themel të drejtën e pronësisë, shkel parimet e demokracisë Kushteturën.

Kërkojmë një President që të angazhojë maxhorancën dhe opozitën për zbatimin e nenit 181 të Kushtetutës, nen i cili me përmbajtjen e tij prapavepruese korigjon gabimet dhe vjedhjet e bëra nga zyrtarët dhe siguron respektimin e të drejtës së pronës konform detyrimeve kushtetuese dhe Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Kërkojmë një President që të jetë produktiv, duke i dhënë fund vjedhjes dhe korrupsionit më pronat që Shqipëria të mos vazhdojë të zhytet më tej në anarkinë e pronës dhe të ndërpriten vrasjet për shkak të pronës. Rikujtojmë politikanët dhe ndërkombëtarët që po anashkalojnë problemin e pronës për përgjigjësin e tyre ato mijëra jetë të humbura dhe disa mijëra familje të ngujuara për shkak të ligjeve të gabuara që në këto 20 vjet krijuan anarkinë e pronës. Shtrojmë pyetjen për Presidentin e ardhëshëm, për z. Berisha z. Rama dhe analistët e politikës: Kush e vrau Skerdilajd Konomin. Ajo nuk ishte një aksident automobilistik, por ishte ekzekutim në mënyrë siçiliane dhe publike, në mes të ditës në mes të qytetit me eksploziv të vendosur në makinë dhe nuk është vrasja e parë për pronat E vecojmë dhe e citojmë këtë vrasje nga mijëra të tjera sepse ajo tronditi më shumë dhe vuri në lëvizje të gjithë median e megjithatë nuk u analizua fakti se kjo vrasje dhe mijëra të tjera të ndodhura pas vitit 1991 për pronën e kanë burimin tek ligjet e gabuara dhe rruga e gabuar me pronat. Kur krimi godit populli stepet. Ky është mosfunksionimi i shtetit ligjor, që tregon supremacinë e korrupsionit dhe gangsterizmit ndaj ligjit.

Kërkojmë një President që të guxojë të demaskojë ata që vazhdojnë të zbatojnë termat e Ramiz Alisë dhe të platformës së Katovicës dhe i quajnë pronarët ishpronarë, që flasin në emër të Kushtetutës por e shkelin atë, duke cenuar rëndë identitetin kombëtar, duke u bërë pjesë e politikave antishqiptare që e nxjerrin Shqipërinë në ankand .

Në pritje të zgjedhjes së Presidentit të Republikës, Shoqata “Pronësi me Drejtësi” ka kërkuar nga ndërkombëtarët, duke ju dhënë dhe projekligjin përkatës, që ata të ndikojnë për korigjimin e gabimeve, kthimin fizik të pronës tek i zoti dhe kompensimi për pronat që shfrytëzohen për nevoja publike,

Kryetar i Shoqatës Kombëtare të të Shpronësuarve

« Pronësi me Drejtësi »
Rrapo Hajredin Danushi